

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 16.07.2012, mori në shqyrtim çështjen penale që u përket:

KËRKUES: PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
ELBASAN
PERSON NËN HETIM: EMILJANO RAMAZANI

OBJEKTI:

Vleftësimin e ndalimit të shtetasit Emiljano Ramazani,
i biri i Durimit dhe i Melihasë, i datëlindjes 05.02.1980,
lindur dhe banues në Elbasan.
Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”
ndaj personit nën hetim Emiljano Ramazani,
i dyshuar për veprën penale të
“Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, i kryer në bashkëpunim,
parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.185 (13-2012-1863), datë 23.03.2011 vendosi:

Vleftësimin e paligjshëm të shtetasit Emiljano Ramazani.
Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për personin nën hetim
Emiljano Ramazani, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
Urdhërohet mbajtja në paraburgim e personit nën hetim Emiljano Ramazani.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.111, datë 17.04.2012, vendosi:

Miratimin e vendimit penale nr.185 (13-2012-1863), datë 23.03.2011, të
Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar rekurs personi nën hetim Emiljano Ramazani, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, i cili kërkon ndryshimin pjesërisht të vendimeve të gjykatave, duke u caktuar një masë sigurimi më e butë, dhe parashtrohet këto shkaqe:

- Vendimet vijnë në kundërshtim me neni 253/1 të K.Pr.Penale, pasi nuk janë respektuar, ose ka gjetur zbatim të gabuar ligji penal.
- Këto vendime vijnë në kundërshtim me neni 228/3b dhe 253/1 të K.Pr.Penale. Rezulton se ndalimi dhe caktimi i masës së sigurimit është bërë në bazë të kërkesës së

Prokurorisë datë 19.03.2011. Gjykata shprehet se ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova se i ndaluar ka kryer veprën e parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

- Nga dhënia e vendimit të gjykatës për lejim përgjimi deri më sot kanë kaluar më tepër se gjashtë muaj dhe nuk është gjetur asnjë provë materiale apo deklarament që të provojë kryerjen e veprës penale
- Megjithatë gjykata pranon se vepra është kryer në muajin korrik dhe shtator të vitit 2011 dhe i ndaluar ka qenë në përgjim deri më sot, nuk ekziston rreziku i ikjes, apo të ketë ndodhur ndonjë ngjarje që të përbëjë shkak për të menduar se mund të largohej.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Shkëlzen Selimi; prokurorin Kujtim Luli, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës; mbrojtësin e personit nën hetim, Av.Nazmi Dervishi; dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se vendimi nr.111, datë 17.04.2012 i Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimi nr.185(13-2012-1863), datë 23.03.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan janë dhënë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal.

Nga aktet e ndodhura në fashikullin e masës së sigurimit, si dhe të provave të paraqitura në seancë gjyqësore të shqyrtimit të masës, ka rezultuar e provuar se:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e materialit referues të Drejtorisë së Policisë Elbasan, ka regjistruar procedimin penal nr.752, datë 20.07.2011 për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.
2. Sipas këtyre materialeve, Seksioni i Luftës kundër narkotikëve, dispononte të dhëna se shtetasi Eduart Ibrahim Muzhaqi në bashkëpunim me persona të tretë merrej me tregtimin e lëndës narkotike të llojit kokainë në zonën pranë universitetit “A. Xhuvani”, Elbasan.
3. Me vendimin nr.391, datë 21.07.2011, mbi kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lejuar përgjimin e bisedave telefonike të numrave të telefonit që përdoren nga shtetasi Eduart Muzhaqi, shtetasi Altin Çaka dhe Florenc Çausi. Në vijim të hetimeve është zgjatur afati për përgjimin e bisedave telefonike si dhe është autorizuar nga prokurori përgjimi i bisedave në ambiente publike të shtetasit Eduart Muzhaqi dhe personave të tjerë.
4. Shtetasi Eduart Muzhaqi është arrestuar në flagrancë nga Policia Elbasan në datë 27.09.2011; në vijim të hetimit me urdhrin e datës 12.10.2011 është urdhëruar transkriptimi i bisedave telefonike të përgjuara në bazë të vendimeve të gjykatës.
5. Nga materialet e transkriptuara të vëna në dispozicion të Prokurorisë ka rezultuar se: “shtetasi Eduart Muzhaqi tregtonte lëndë narkotike, të llojit kokainë, të cilën ia shpërndante përdoruesve të ndryshëm në qytetin e Elbasanit. Në momentin që ky shtetas nuk kishte lëndë narkotike, bën rolin e ndërmjetësit me personat e tjerë, edhe këta shpërndarës të lëndës narkotike, duke siguruar lëndë për klientët e tij. Kështu shtetasi Eduart Muzhaqi me ndërmjetësimin e shtetasve Kostandin Piku, Altin Çaka, Ilir Rrapi e Petrit Bekteshi shet lëndë narkotike. Në rastet kur shtetasi Eduart Muzhaqi nuk ka lëndë narkotike e blen tek shtetasi Emiljano Ramazani dhe persona të tjerë nëpërmjet Altin Çakës.
6. Në këto kushte në datë 19.03.2012 është nxjerrë prej prokurorit urdhri për ndalimin e të dyshuarit Emiljano Ramazani me arsyetimin se dyshohet për kryerjen e një krimi

dhe se ka rrezik të ikë, duke iu shmangur procedimit penal kundër tij, urdhër i cili është ekzekutuar datë 19.03.2011, ora 23⁴⁵.

7. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan lidhur me vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

II. Procedurat gjyqësore

8. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan** me vendimin nr.185 (13-2012-1863), datë 23.03.2012, vendosi:

Vleftësimin e paligjshëm të shtetasit Emiljano Ramazani.

- i. Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për personin nën hetim Emiljano Ramazani, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
 - ii. Urdhërohet mbajtja në paraburgim e personit nën hetim Emiljano Ramazani.
9. Pas ankimit të personit nën hetim, Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.111, datë 17.04.2012, vendosi:
 - i. Miratimin e vendimit penale nr.185(13-2012-1863), datë 23.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

10. Kundër vendimeve të mësipërme ka ushtruar **rekurs personi nën hetim Emiljano Ramazani**, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, i cili kërkon ndryshimin pjesërisht të vendimeve të gjykatave, duke u caktuar një masë sigurimi më e butë, dhe parashtron shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit.

III. Arsyetimi ligjor i vendimit të ankimuar

11. Gjykata e Apelit Durrës e konsideron të drejtë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe arsyeton: “...*në rastin konkret dyshimi i bazuar në prova se shtetasi Emiljano Ramazani mund të ketë kryer veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, neni 283/2 i K.Penal... nga përmbajtja e fashikullit që përmban akte të fazës së hetimeve paraprake, nga përmbajtja e të cilave rezulton se shtetasi nën hetim Emiljano Ramazani ka pasur komunikim të shpeshtë me shtetasin e arrestuar Eduart Muzhaqi në periudhën e realizimit të përgjimit të autorizuar nga gjykata. Nga tërësia e bisedave të zhvilluara të krijohet dyshimi se shtetasi nën hetim Emiljano Ramazani ka konsumuar elementët e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Kjo duhet të vlerësohet në harmoni edhe me faktin e shtrirjes në kohë të aktivitetit të shpërndarjes së lëndës narkotike të llojit kokainë prej shtetasit Eduart Muzhaqi, proces-verbalit të sekuestrimit të lëndës narkotike dhe aktit të ekspertimit kimik të lëndës narkotike...”*

IV. Në lidhje me rekursin e paraqitur nga personi nën hetim

12. **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arrin në konkluzionin se rekursi i paraqitur nga personi nën hetim Emiljano Ramazani nëpërmjet përfaqësuesit të tij është i bazuar në ligj (Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale) dhe si i tillë duhet të pranohet.**
13. Vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në lidhje me caktimin e masës së sigurimit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural, ç’ka ka sjellë si pasojë që vendimi të jetë i gabuar.
14. Kolegji Penal vlerëson se të dyja gjykatat, si ajo e apelit, ashtu edhe gjykata e shkallës së parë në caktimin e masës “arrest në burg”, nuk kanë marrë parasysh mungesën e kushteve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga neni 228 i K.Pr.Penale lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Në nenin 228/1 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “1. Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”.

15. Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, sipas pikës 1 të nenit 228, nënkupton për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, pra për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim dhe i pandehuri të ketë kryer veprën penale. Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit dhe të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij. Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë ezaurues, domosdoshmërisht në drejtim të fajësisë. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit.
16. Mbi arsyetimin e mësipërm, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.7, datë 14.10.2011, kanë arritur në përfundimin unifikues se: ***dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit dhe të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij.***
Dispozita e pikës 1 të nenit 228 tregon vetë dallimin e natyrës së veçantë të gjykimit dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës për caktimin ose jo të masës së sigurimit krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Në rastin e parë, gjykimi mbështetet në dyshime të arsyeshme bazuar në prova, që tregojnë mundësinë e kryerjes së veprës penale objekt procedimi dhe mundësinë e atribuimit, pra të ekzistencës së fajësisë, pikërisht në drejtim të të gjykuarit për atë veprë penale (fumus commissi delicti), ndërsa në rastin e dytë, gjykimi mbështetet vetëm në prova që vërtetojnë, jashtë çdo dyshimi, dhe e bindin gjykatën për kryerjen ose jo të veprës prej tij.
17. Prokurori në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se dyshimin e arsyeshëm për kërkesën për caktim masë siguri personal ndaj personit nën hetim Emiljano Ramazani, e ka bazuar ***në përgjimet e lejuara me vendim të gjykatës***, ku me vendimin nr.391, datë 21.07.2011, mbi kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lejuar përgjimin e bisedave telefonike të numrave të telefonit që përdoren nga shtetasi Eduart Muzhaqi, shtetasi Altin Çaka dhe Florenc Çausi. Nga ky vendim i gjykatës nuk rezulton që të jetë lejuar përgjimi i numrit të telefonit të personit nën hetim Emiljano Ramazani, por vërehen komunikime të shpeshta ndërmjet këtij të fundit dhe personit tjetër nën hetim Eduart Muzhaqi.
18. Po kështu informacioni i siguruar nga përgjimi telefonik dhe ai parandalues nuk krijojnë bindjen e mjaftueshme se personi nën hetim Emiljano Ramazani të jetë përfshirë në bashkëpunim me personat e tjerë në tregtimin e lëndës narkotike. Gjatë bisedës së zhvilluar nuk del asnjë e dhënë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë që të implikojë personin nën hetim me pasjen dijeni dhe të bashkëpunimit për drogën e kapur.
19. Gjykata e shkallës së parë, si edhe ajo e apelit, kanë gabuar në caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” në mungesë të provave, të cilat e implikojnë të dyshuarin në kryerjen e veprës penale për të cilën dyshohet. Këto gjykata në vendimin e caktimit të masës së sigurimit, megjithëse i referohen dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova në vendimin e tyre citojnë disa transkripte të bisedave telefonike të personit nën hetim me persona të tjerë, të cilat nuk citojnë asnjë provë konkrete e cila e implikon personin nën hetim Emiljano Ramazani në lidhje me veprën për të cilën dyshohet.

20. Këto gjykata me të drejtë ka vleftësuar si të paligjshëm arrestin në flagrancë, pasi ka konstatuar se nuk janë kushtet e parashikuara nga neni 252 i K.Pr.Penale¹. Sipas kësaj dispozite, gjendja e flagrancës lidhet me tri situata faktike që kanë të bëjnë me: i) kapjen e personit në kryerje e sipër të veprës penale ii) ndjekjen dhe kapjen menjëherë nga ana e policisë gjyqësore iii) personi kapet me sende dhe prova materiale që kanë lidhje me veprën penale.
21. Nga rrethanat e faktit të parashtruara rezulton se personi nën hetim Emiljano Ramazani nuk është arrestuar në asnjë prej situatave që të motivojnë gjendjen e flagrancës.
22. Por në kushtet kur nga përgjimet e kryera nuk janë arritur të merren të dhëna të cilat ta implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë personin nën hetim Emiljano Ramazani, asnjë masë sigurimi personal nuk mund të merret kundër tij.
- V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes**
23. Vendimi nr.111, datë 17.04.2012 i Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimi nr.185 (13-2012-1863) datë 23.03.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në lidhje me caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit Emiljano Ramazani, janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe si të tilla duhen të shfuqizohen.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 249 pika “8” e Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

Ndryshimin e vendimit nr.111, datë 17.04.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës në këtë mënyrë:

Rrëzimin e kërkesës për caktim masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim Emiljano Durim Ramazani.

Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim në rast se nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër.

Urdhërohet Prokurori pranë Gjykatës së Lartë për ekzekutimin e këtij vendimi.

Tiranë, më 16.07.2012

¹ Neni 252 i K.Pr.Penale “Gjendja e flagrancës”

Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.